45 pikë

PROCEDURË CIVILE

**TEZA 4**

1. **Përcaktoni nëse pohimet e mëposhtme janë të vërteta apo të gabuara (shënoni me V- e vërtetë dhe X – e gabuar)**

   (6)

   a. Kundër vendimit të gjykatës, që ka shpallur kompetencën për gjykimin e çështjes bëhet ankim i veçantë. ( V )
   b. Kundër vendimit të gjykatës, që ka shpallur moskompetencën për gjykimin e çështjes bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit.( X )
   c. Kundër vendimit të gjykatës, që ka shpallur kompetencën për gjykimin e çështjes mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit, bashkë me vendimin përfundimtar. ( V )
   d. Shkresa që shpallet e falcifikuar i jepet ndërgjyqësit së bashku me vendimin, që shpall shkresën të falsifikuar. ( X )

8 pikë

2. **Rrumbullakosni përgjigjen e saktë:**

   (4)

   a. Kur palët ose prokurori që kanë ngritur padi, për shkaqe të arsyeshme kanë humbur afatin ligjor ose atë të caktuar nga gjykata, mund të kprkojnë në çdo rast rivendosjen në afat.
   b. Gjykata mund të zgjasë, pasi ka mbaruar afati me vendim atë, nëse ai (afati) nuk është prekluziv.
   c. Ankimi në Gjykatën e Apelit dhe rekursi në Gjykatën e Lartë nuk mund të bëhet pasi ka kaluar një vit nga shpallja e vendimit.

4 pikë

3. **Gjykata, që ka dhënë vendimin nuk e pranon ankimin kur:**

   (10)

   a) Ankimi është ushtruar tej afatit të përcaktuar ligjor.
   b) Ankimi është ushtruar nga personi që nuk ka të drejtën e ankimit, apo nuk ka rregulluar të metat e ankimit të lëna për plotësim nga Gjykata.
   c) Ankimi bëhet ndaj një vendimi ndaj të cilit nuk lejohet ankim.
   d) Kur ankimuesi ka hequr dorë nga ankimi.
   e) Kur Ankimi i ushtruar nga mbrojtësi nuk është shoqëruar me prokurën përkatëse.

10 pikë

4. **Ndaj cilëve subjekte vendimi gjyqësor i formës së prerë është i detyrueshëm? A mund të gjykohet përsëri nga gjykata një konflikt që është zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë?**

   (8)

   - Vendimi gjyqësor i formës së prerë është i detyrueshëm për palët në proces, në atë që është vendosur në gjykim. Ndaj personave apo trashëgimtarëve që tërheqin të drejta nga palët e procesit. Ndaj çdo institucioni që i drejtohet dhe ndaj çdo gjykate tjetër.
   - Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri nga gjykata, vetëm për rast të rishqyrtimit / rishikimit.

8 pikë

5. **Shpjegoni cili është ndryshimi midis konceptit "zgjatja e afateve" dhe "rivendosjes në afat" sipas K.Pr.C?**

- Zgjatja e afateve, ju referohet rasteve kur gjykata një afat të caktuar prej saj, për shkaqe të arsyeshme vendos ta zgjatë atë, duke i dhënë kohë/mundësi palëve të paraqitin prova/qëndrimet
- Rivendosja në afat, i referohet rastit kur palët për shkaqe të ndryshme e kanë humbur të drejtën e tyre për të ushtruar një të drejtë të tyre procedurale, e për këtë i drejtohen me kërkesë gjykatës kompetente.
- Dallimi qëndron përsa i përket momentit të zbatimit dhe qëllimit të tij. Zgjatja i referohet situatës kur një veprim nuk është përmbyllur brenda afatit dhe ligji lejon kitë zgjatje. Ndërsa Rivendosja i referohet rastit kur pala as nuk e ka filluar kërkimin për ushtrimin e të drejtës së saj.

Shumë dakort, por duhet jo shumë i plotë (-2) Shih neni 146, 147, 151 e 458.

10 pikë

3

6. **Jepni përkufizimin e akteve procedurale.**

- Aktet procedurale ju referohen: shkresave zyrtare, private, padisë, kundërpadisë, procesverbaleve, ankimit, propozimeve, si edhe çdo element të tjetër të materializuar në një proces, i cili përbën pjesë të një procedure të plotë gjyqësore civile në këtë rast.
- Aktet procedurale duhet të kryhen në formën e duhur kur përcaktohet nga ligji
- Aktet procedurale përbëjnë të gjitha aktet që fillojnë me paraqitjen e padisë e deri në përfundimin e procedurës përkatëse.

Jo e plotë (1)

4 pikë

3

7. **Pala kundër së cilës është paraqitur si provë një shkresë mund të kundërshtojë vërtetësinë e saj me njërën nga këto mënyra:**

a) Duke e kundërshtuar për falsitet
b) Duke deklaruar se nuk është ai (pala) që e ka nënshkruar aktin/shkresën
c) Duke deklaruar që nuk di se, akti/shkresa është nënshkruar nga trashëgimtari i tij.

6 pikë

6

Totali: 46 pikë

TEZA 1

## E DREJTË EUROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE PUBLIKE

**I. Shënoni përkatësisht me V ose X sipas rastit përgjigjen e vërtetë ose të gabuar. (çdo pyetje vlerësohet me 2 pikë)**

1. Gjykata Europiane e Drejtësisë ushtron pushtetin gjyqësor në BE. V
2. Gjykata Europiane e Drejtësisë ka kompetencën për t'u shprehur në rrugë paragjykimore mbi interpretimin dhe vlefshmërinë e akteve dytësore. V
3. Gjykata Europiane e Drejtësisë shqyrton rekurset në lidhje me mospërmbushjet e detyrimeve të shteteve anëtare. V
4. Gjykata Europiane e Drejtësisë shqyrton kontrollin mbi legjitimitetin e akteve komunitare. V
5. Gjykata Europiane e Drejtësisë ushtron edhe pushtetin ekzekutiv në BE. X

**II. Rrumbullakos përgjigjen e saktë (çdo pyetje vlerësohet me 2 pikë)**

1. Koncepti i sovranitetit :
   a) është nocion më i ngushtë se pavarësia
   b) përfshihet tek pavarësia
   c) është një nocion më i gjerë se pavarësia
   d) është aspekti i jashtëm i pavarësisë

2. Protektorati vendoset:
   a) për shkak të ligjeve për trashëgiminë e fronit
   b) me anë të një marrëveshje dypalëshe ose akteve të njëanshme
   c) me pushtim

3. Neutraliteti i Shqipërisë:
   a) ka ekzistuar nga viti 1913 deri në Luftën e Parë Botërore
   b) ka ekzistuar në periudhën midis dy luftërave botërore
   c) është diskutuar disa herë por nuk është vendosur në asnjë periudhë të ekzistencës së shtetit shqiptar

4. Refuzimi i njohjes së një shteti të ri duhet të bëhet kur:
   a) shteti i ri nuk ka qëndrueshmëri
   b) shteti i ri nuk i ka të gjithë elementët kushtetues
   c) shteti i ri është krijuar si rezultat i përdorimit të paligjshëm të forcës
   d) shteti i ri nuk ka pushtet efektiv në të gjithë territorin e tij

5. *Rebus sic stantibus* do të thotë:
   a) pushimi i fuqisë juridike të traktatit për shkak të ndryshimit thelbësor të rrethanave
   b) pushimi i fuqisë juridike të traktatit për shkak të mbarimit të afatit
   c) pushimi i fuqisë juridike të traktatit me marrëveshje të palëve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SHKOLLA E MAGJISTRATURËS TIRANË

**TEZA 1**

## E DREJTË EUROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE PUBLIKE

**III. Jepni konceptin e saktë. ( çdo pyetje vlerësohet me 5 pikë)**

1. Për nocionin "Hapësira pa kufij të brendshëm" në BE. (5 pikë)

- Nënkupton lëvizjen e personave, mallrave, kapitaleve, dhe shërbimeve, nga një shtet i BE në tjetrin pa u kushtëzuar nga pengesa që mund të jenë: fizike, teknike, fiskale etj ✓

5

→ Kufijtë i ju referohen çdo lloj ndalimi që mund t'iu bëhet lirive (4 lirive), dhe nënkupton një hapësirë ku personi (qytetari Europian) është i aftë të sillet njëlloj në [illegible] çdo vend të BE

2. Procedura e bashkëvendosjes në kuadër të miratimit të akteve juridike në BE. (5 pikë)

→ Bashkëvendosja i referohet të drejtës së përbashkët që ka Parlamenti i BE me Këshillin e BE për të nxjerrë dhe miratuar akte juridike të BE-së.

5

- Si rregull iniciativa i përket Komisionit, për propozimin e akteve juridike dhe në një procedurë të përbashkët mes Parlamentit dhe Këshillit

→ Bashkëvendosje e PE me Këshillin që të [illegible] pa miratim të akteve juridike por edhe në proces [illegible] mocioni për Kushtetutën, Buxhetin etj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SHKOLLA E MAGJISTRATURËS TIRANË

TEZA 1

# E DREJTË EUROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE PUBLIKE

## IV. Bëni krahasimin e koncepteve të mëposhtme. (çdo pyetje vlerësohet me 5 pikë)

1. Bëni krahasimin ndërmjet Rregulloreve dhe Vendimeve si akte juridike të detyrueshme në BE. (5 pikë)

Rregullorët -> janë akte të detyrueshme, akte të strukturuar dhe u drejtohen së rregulli të gjitha vendeve anëtare

Vendimet -> janë akte të detyrueshme, që u drejtohen 1-vendi, 1-organi apo 1-individi.

E përbashkëta është karakteri i detyrueshëm i tyre

Dallimi e kryeri i subjekteve (që u drejtohen)

5

2. Bëni krahasimin ndërmjet lirive dhe të drejtave themelore që sanksionon Karta e të Drejtave të BE-së me KEDNJ-në. (5 pikë)

- KEDNJ -> si rregull i përfshin brenda saj edhe Shtetet anëtare të BE, përveç shteteve anëtare të Këshillit të Europës
- KEDNJ -> përcakton të drejta universale të detyrueshme dhe të pa-detyrueshme në zbatimin, duke përmbajtur një minimum të detyrueshëm
- Karta e të Drejtave të BE -> i referohet së rregulli vetëm shteteve anëtare të BE
- Karta e të Drejtave -> një standart më specifik sesa KEDNJ

5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË SHKOLLA E MAGJISTRATURËS TIRANË

**TEZA 1**

## E DREJTË EUROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE PUBLIKE

**V. Analizoni ose përshkruani. (Kjo pyetje vlerësohet me 10 pikë)**

1. Flisni për risitë që solli Traktati i Lisbonës ne kompetencat e Parlamentit Europian. (10 pikë)

-> Traktati i Lisbonës (v. 2007) [illegible] solli më tepër rëndësi dhe pushtete e Parlamentit Europian

-> Parashikoi dhe përcaktoi se sa do të jetë numri i anëtarëve të PE, në zgjedhjet e ardhshme

-> Parashikoi krijimin e një organi të posaçëm me objekt, pranimin e ankesave nga subjektet mbi mënyrën e zbatimit të të drejtës së BE, dhe identifikimin e shkeljeve të mundshme në organet e BE

-> Konfirmoi edhe njëherë të drejtën e PE, për të miratuar aktet ligjore me këshillim.

-> Të drejtën e mocionit ndaj [illegible]

(10)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
TIRANË

E drejta civile

**TEZA 2**

4/5

**I. Shënoni me V shprehjet e vërteta dhe me X ato që janë të gabuara**

__G__ 1. Fëmija kur lind i gjallë gëzon zotësi juridike që nga koha e lindjes.

__V__ 2. Mospengimi i një ngjarjeje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjanuar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar.

__V__ 3. Pranimi i propozimit që nuk përputhet me përmbajtjen e tij, quhet mospranim dhe njëkohësisht si një propozim i ri.

__V__ 4. Personat juridikë që ndjekin qëllime ekonomike regjistrohen.

__G__ 5. Objekti i detyrimit është gjithmonë një vlerë monetare.

__G__ 6. Vetëm kur kontrata e transportit të personave është ka kundërshpërblim, palët mund të bien dakort për kufizimin e përgjegjësisë së transportuesti për rreziqet ndaj udhëtarit.

__G__ 7. Kërkesa për lëshimin e dëshimisë së trashëgimisë bëhet para noterit ku e ka vendin e banimit kërkuesi.

__G__ 8. Poseduesi me mirëbesim nuk ka të drejtë të kërkojë pagimin e shpenzimeve të nevojshme që ka bërë me sendin.

__G__ 9. Nëse uzufrukti është pa afat, ai mbaron vetëm mbi kërkesën e uzufruktarit apo trashëgimtarit të tij.

__V__ 10. Bashkëpronari ka të drejtë të tjetërsojë ose disponojë në çdo mënyrë tjetër pjesën e tij në sendin e përbashkët të paluajtshëm tek bashkëpronarët e tjerë.

(10 pikë)

(10)

**II. Plotësoni fjalitë dhe jepni sqarimet e mëposhtme:**

a. Publikimi quhet mashtrues kur përcaktimi i përbërjes apo përmbajtjes së mallit/sendit në etiketimin e tij/ambalazhimin e tij nuk i korespondon cilësive reale që gëzon sendi konkret. Në këto raste prodhuesi ngarkohet me përgjegjësi sipas kushteve të nenit 618 e vijues të K.Civil për shpërblimin e dëmit

a. 617. 1-2

b. Detyrimet alternative janë kur debitori për përmbushjen e detyrimit çlirohet prej tij (detyrimit), me ekzekutimin e njërit prej detyrimeve të përcaktuar/parashikuar. Fillimisht e drejta e zgjedhjes i përket debitorit, nëqoftëse palët nuk kanë parashikuar ndryshe. Kjo e drejtë (e zgjedhjes) mund ti lihet edhe 1 të treti.

2.

(2)

c. Pavlefshmëria absolute e veprimeve juridike nënkupton kur veprimi juridik i kryer nuk sjell asnjë pasojë. Ai konsiderohet si kur nuk është kryer kurrë. Veprimi absolutisht i pavlefshëm

1.

vjen në vijim të [illegible] [illegible]

nuk bëhet: vlefshëm me asnjë akt të mëposhtëm. Këto lloj veprimesh (absolutisht të pavlefshme) përcaktohen në Kodin Civil, neni 92: Kj.

d. Përsa i përket formës kontrata e sigurimit të pasurisë duhet të bëhet me shkresë (në) dhe siguruesi duhet të nënshkruajë dhe lëshojë këtë kontratë në formën e policës së sigurimit. Kjo kontratë/policë përmban elementet e nevojshëm të pronës, shumën e siguruar, datën etj. (10 pikë=3+2+3+2 pikë)

**III. Shpjegoni ndryshimin koncepteve apo instituteve të mëposhtme:**

Përmendni kontratat që kanë në objektin e tyre transferimin apo përdorimit të të drejtave, krahas vetë sendeve? kalimin e pronësisë

1) Kontrata e Shitjes së Pasurisë, përveç sendit ka për objekt të saj edhe kalimin e të drejtave që bashkëshoqërojnë atë.
2) Kontrata e Shkëmbimit → Transferon njëkohësisht (shkëmben) sendet përkatëse, njëkohësisht edhe të drejtat që ushtrohen ndaj sendeve
3) Kontrata e Dhurimit → Ka për objekt dhe transferon (pas pranimit të dhurimit) edhe sendin edhe të drejtat mbi të.
4) Kontrata e Pengut → Kalon sendin apo titullin (përgjithësisht sendi kalon në përdorim Pengmarrësit) dhe ai mund ta përdorë atë (jo t'ja japë tjetrit)
5) Kontrata e Enfiteozës → Pronari i kalon enfiteozmarrësit për përdorim pronën e paluajtshme si edhe të drejtën e përdorimit e shfrytëzimit të saj.
(6) Kont

(10 pikë)

***IV. Emërtoni definicionet e mëposhtme duke dhënë konceptin përkatës.***

a. Në një kontratë, kur shkaku i saj vjen në kundërshtim me ligjin, rendin publik, ose kur kontrata bëhet mjet për të shmangur zbatimin e një norme quhet shkak i paligjshëm / fiktive.

b. Në një marrëdhënie detyrimi mund të ndodhë që kreditori ose secili nga kreditorët ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e të njëjtit detyrim tërësisht apo pjesërisht si nga debitorët së bashku, ashtu dhe nga secili prej tyre veç e veç. Ky është koncepti i detyrimit solidar.

c. Për mosekzekutimin ose ekzekutimin jo në mënyrën e duhur të detyrimeve, palët mund të parashikojnë në kontratë pagimin e një shume të hollash ose kryerjen e një detyrimi tjetër,

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SHKOLLA E MAGJISTRATURËS TIRANË

për riparimin e dëmit ose për të nxitur ekzekutimin e detyrimit. Ku quhet kushti penal.

d. Cilido që ka bërë një pagim të padetyruar ka të drejtë të kërkojë kthimin e asaj që ka paguar si dhe të gëzojë frytet dha kamatat nga dita e pagimit, nëse personi që ka marë pagesën është në keqëbesim, dhe nga nga dita e kërkesës për kthimin, kur personi është në mirebesim. Ky është definicion i pagimit të padetyruar.

e. Kalimi me ligj ose me testament i pasurisë të personit të vdekur, një ose më shumë personave quhet Trashëgimi. (10 pikë=2+2+2+2+2 pikë)

**V. Jepni shpjegimet e mëposhtme:**

a. Tek cila kontratë ndeshet "e drejta e ekskluzivitetit"? Shpjegojeni.

E drejta e ekskluzivitetit ndeshet tek Kontrata e furnizimit. Kjo e drejtë mund të parashikohet dhe vendoset në favor të furnizuesit ose të të furnizuarit. Kur është në favor të furnizuesit, i furnizuesi nuk duhet të furnizohet nga një subjekt tjetër dhe as ta prodhojë vetë. Kur është parashikuar në favor të të furnizuarit, furnizuesi nuk duhet të furnizojë subjekte të tjerë në atë zonë.

b. Cilët janë llojet e personave juridikë publikë?

Personat juridikë publikë përfaqësohen nga institucionet e administratës shtetërore qëndrore e vendore, nga entet publike të krijuara me qëllim ushtrimin e një funksioni apo shërbimi publik.

c. Kushtet për të vërtetuar padënjësinë në rrugë gjyqësore nënkuptojne ato procedura gjyqësore që kanë për objekt të tyre të provuarit e një rrethane e cila sipas përcaktimeve ligjore, e bën një person të padenjë esi të tillë të doktë për të trashëguar. Padenjësia kërkohet për rastet kur dikush trashëgimtari ka vrarë apo tentuar vrasje trashëlënësin ose b/shortën, fëmijët, prindërit etj. ka kanosur apo bërë 1- testament të rremë. Ose kur është sjellë në mënyrë poshtëruese ose kontrafer TSH.

d. Hipoteka gjyqësore është ajo nënkupton rastin kur gjykata me vendim ka disponuar në lidhje me (1) përcaktimin e detyrimit në të holla që rëndon ndaj një personi (debitorit) në favor të një personi tjetër. (2) Me vendim disponohet për dhyerjen e një veprimi që të caktuar

(10 pikë=2+3+3+2 pikë)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SHKOLLA E MAGJISTRATURËS TIRANË

42 pikë

**TEZA 21**

**E DREJTE PENALE**

1. ***Po/ Jo ( 1 pike secila pyetje ). Shenoni me shenjen plus (+) pohimin dhe, me shenjen minus (-) mohimin. Gjithsej 10 pike.***

   a. A duhet te jete demi i zbrapsur i barabarte me ate te shkaktuar ne menyre qe te jemi perpara mbrojtjes se nevojshme ? — ✓
   b. A detyrohet personi vetem nga ligji per te vepruar ne menyre qe te mos jete subjekt i vepres penale te Mosdhenijes Ndihme, neni 97 Kodit Penal ? — ✓
   c. A eshte numri i personave qe marrin pjese ne kryerjen e vepres penale ndikues ne percaktimin e mases se denimit ndaj tyre ? + ✓
   d. A eshte i rendesishem per ekzistencen e vepres penale te genocidit, neni 73 Kodit Penal, ekzistenca e nje plani te paramenduar ? + ✓
   e. A eshte shuma e vleres se pasurise se vjedhur element i domosdoshem per qenien ose jo te vepres penale ? — ✓
   f. A perben veper penale nese nje person ne paaftesi te plote e dergon subjektin e tij tregtar ne gjendje falimenti ? — ✓
   g. A mund te denohet penalisht nje person nese ka kryer vepren nen urdherat haptazi te paligjshme te dhena nga eprori i tij ? — ✗
   h. A eshte I mjaftueshem deklarimi ne gjykate per nje krim qe eshte kryer ne menyre qe personi te mos jete subjekt i vepres penale te Moskallzimit te krimit ? — ✗
   i. A mund te lehtesohet denimi penal ndaj nje personi qe ka kryer vepren penale ne gjendje te dehur ? + ✓
   j. A eshte i rendesishem pelqimi i te denuarit ne rastin kur gjykata vendos detyrimin e tij te kryeje nje pune ne interes publik ? + ✓

8 pikë

2. ***Beni krahasimin :***

***Dallimet dhe elementet e perbashket qe permbajne konceptet " parashkrimi I ndjekjes penale ", neni 66 Kodit Penal dhe, " parashkrimi I ekzekutimit te denimit", neni 68 Kodit Penal. ( 10 pike )***

- Të dyja institutet kanë në thelb të tyre kalimin e një kohe të caktuar. Me kalimin e kësaj kohe sipas përcaktimit të nenit 66 dhe 68 të Kodit Penal ndjekja penale apo ekzekutimi i vendimit të dënimit nuk bëhet ✓

- Në të dyja rastet personi nuk i është nënshtruar karakterit represiv të ligjit (përveç kur në rastin e nenit 68 të K. Penal) i dënuar është liruar/amnistuar nga vendi i vuajtjes së dënimit ✓

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SHKOLLA E MAGJISTRATURËS TIRANË

- Parashkrimi i ndjekjes penale i referohet rastit kur personi nuk është vendosur ndjekjes penale apo kur brenda afatit të përcaktuar të parashkrimit nuk është marrë i pandehur

- Parashkrimi i ekzekutimit i referohet rastit kur i dënuar brenda afatit të caktuar nuk është kapur apo gjetur për t'ju nënshtruar dënimit

* Në të dyja rastet, ndërpritet kalimi i kohës sipas nenit 66 dhe 68 të K.Penal sipas veprës penale që procedohet

* Në të dyja rastet kalimi i afatit sjell shuarje të veprës penale pasi në nenin 66 të K.penal, shuhet e drejta për të nisur ndjekje penale në nenin 68 të K.Penal shuhet e drejta për ta vendosur të dënuarin në burg.

Dallimet jo të plota! (3 pikë)

3. ***Nga dallojne veprat penale te " vrasje e kryer ne gjendje te tronditjes se forte psikike" neni 82 Kodit Penal, nga "...vrasja e kryer ne kapercim te kufinjve te mbrojtjes se nevojshme", neni 83 Kodit-Penal ? ( 10 pike).***

Vrasja në gjendje të tronditjes së fortë psikike, (Neni 82) referohet situatës kur personi për shkak të një situate konkrete të ndodhur, ka humbur kontrollin e tij, dhe në këtë gjendje të tronditjes që ka pësuar gjithë konshiencën e tij ka kryer veprën penale. Në këtë rast, si shkak për kryerjen e veprës penale ka shërbyer pikërisht sjellja konkrete e cila e ka tronditur dhe ndikuar thelbësisht psikikën e personit, që ka kryer veprën penale të vrasjes në këtë mënyrë.

- Vrasja në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme (83) i referohet rrethanave kur personi për të shmangur një sulm të vërtetë, të padrejtë të atëçastshëm ndaj shëndetit, jetës, interesit apo të drejtës, i është kundërpërgjigjur këtij sulmi. Mjetet e kundërpërgjigjes së sulmit, duhet të jenë haptazi jo proporcionale duke sjellë vdekjen e sulmuesit.

-> Dallimet: Tek Neni 82, tronditja mund të vijë nga çdo sjellje ndaj personit/autorit por jo të sulm fizik ndaj tij.

- Tek neni 83, veprimi i autorit bëhet vetëm si kundërpërgjigje ndaj sulmit të bërë

Tek N. 82 => Nuk ka rëndësi mjeti i përdorur për veprën penale

Tek N. 83 => Duhet që mjetet e kundërpërgjigjes duhet të jenë haptazi jo proporcionale

- Mungesa e provokimit te n. 83 !

8 pikë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SHKOLLA E MAGJISTRATURËS TIRANË

4. *Referuar nenit 130/a te Kodit Penal, " Dhuna ne familje " parashikohen , nder te tjera, pasojat qe duhet te rezultojne nga dhuna e perdorur, qe jane "...cenimi i integritetit fizik, psikosocial dhe ekonomik..." te viktimes. Ne dispozite nuk permendet qellimi i autorit te vepres penale.*

***Parashtroni analizen tuaj rreth lidhjes qe duhet te ekzistoje tek vepra ne fjale ndermjet qellimit te autorit te saj kur ushtron dhunen, me pasojat qe dispozita kerkon te vertetohen. Perse ligjvenesi ka zgjedhur te jete i hapur duke mos kushtezuar qenijen e kesaj vepre me qellimin e autorit te saj per te arritur pasojat qe permenden lart ? Mund te ilustroni opinionin tuaj me praktike gjyqsore, nese jeni ne kontakte me te.. ( 10 pike )***_____

- Dhuna në familje përbën një krim, i cili përsa i përket anës objektive nga të cilat kryet parashikohet në kodin penal [illegible].

- Qëllimi nuk është parashikuar si element, me qëllim për t'i ofruar një mbrojtje më të gjerë, mesit të personave [illegible] pasiv [illegible] të dhunës në familje.

- Forma: Me dhunë fizike, psikologjike, apo edhe ekonomike p.sh. duke e [illegible] pa ngrënë ose pa i dhënë apo i marrë të hollat për [illegible].
Pra, parashikon të gjitha format e dhunës.

- Pasojat → [illegible] I, mbulon çdo lloj dhune të ushtruar [illegible]
— " — II, kur pasojat [illegible] në [illegible]
— " — III, [illegible] e vepr[illegible] [illegible]
— " — IV, në prezencë të fëmijëve të mitur.

Qëllimi nuk parashikohet pasi mbrojtja në të gjerë të [illegible] të dëmtuar, por edhe pa të dëmtuar çdo lloj forme dhune në familje.
Familja gëzon mbrojtje të veçantë ligji.

7 pikë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
TIRANË

5. *Prokurori ka ngritur akuze ndaj nje personi, perpara Gjykates Tirane, per kryerjen e vepres penale te Shtytja e te miturit ne krim, neni 129 Kodit Penal, qe permban kete formulim : "shtytja ose terheqja e te miturve nen moshen 14 vjec per te kryer krim, denohet…".*
*Ne perfundim te gjykimit kerkon denimin e fajtorit dhe, perkrah denimit kryesor kerkon edhe zbatimin e nenit 43/a, denimin plotesues te Humbjes se pergjegjesise prinderore. Kjo dispozite permban se "…jepet nga gjykata ndaj personit qe e ushtron pergjegjesine prinderore kur ai denohet si autor ose bashkepunetor ne nje veper penale ndaj femijes ose si bashkepunetor me femijen ne kryerjen e nje vepre penale.*
*Mendoni se duhet pranuar kerkesa e prokurorit per zbatimin e denimit plotesues te kerkuar nga ai ? ( 10 pike)*_____

Neni 43/a si dënim plotësues parashikohet në K. Penal si : ……, [illegible] ………
→ Si dënim plotësues ai parashikon rastin e aplikimit të heqjes së përgjegjësisë

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHKOLLA E MAGJISTRATURES
TIRANE

prindërore kur: • Prindi ka kryer një vepër penale kundër fëmijës ose
• Prindi ka kryer një vepër penale në bashkëpunim me fëmijën.

• Në rastin konkret, megjithëse fëmija për shkak të moshës si mitur nuk mban përgjegjësi penale sipas ligjit, ai është përdorur nga prindi si autor apo bashkëautor i veprës penale, duke përmbushur elementët e nenit 43/a të K. Penal.
• Rezulton se, fëmija është i pazotë për shkak moshe, ai konsiderohet si bashkëpunëtor, për efekt të aplikimit të veprës sipas nenit 43/a të K. Penal ndaj prindit.

Mendoj se Gjykata duhet ta pranojë kërkesën e prokurorit, dhe të aplikojë dënimin plotësues të heqjes së përgjegjësisë prindërore.

Përveç kësaj, prindi është kujdestari e përkohshëm edukues dhe shembulli i fëmijës, duke qenë i detyruar të angazhohet në mirëmbajtjen dhe edukimin e tij.

Me sjelljet/ strategji në këtë rast ka cënuar thelbësisht misionin dhe detyrimin bazë edukimit dhe ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ndaj fëmijës.

10 pikë

41 Pikë

**TEZA 7**
**PROCEDURË PENALE**

**I. Shënoni me V ose G, përkatësisht përgjigjen e vërtetë ose të gabuar ( çdo përgjigje e saktë - 1 pikë; gjithsej – 5 pikë)**

5 Pikë

1. V Seanca paraprake duhet të zhvillohet me dyer të mbyllura.
2. G Kur ka marrëveshje mes palëve, ndarja e çështjeve duhet të pranohet në çdo rast.
3. V Vendimet për caktimin e masave të sigurimit, të ndryshme nga arrestimi, i njoftohen të pandehurit nga gjykata.
4. G Pasojat procedurale të ikjes shtrihen edhe në procedimet e lidhura me atë ku është deklaruar ikja.
5. G Dokumentet që përmbajnë njoftime anonime nuk mund të përdoren në asnjë rast.

**II. Vendosni shenjën «+» ose «x» tek alternativa e saktë (çdo përgjigje e saktë - 2 pikë; gjithsej – 10 pikë):**

6 Pikë

**1. Afati i hetimeve paraprake fillon të llogaritet duke marrë si referim:**

- [+] *datën e rregjistrimit të procedimit penal*
- ☐ *datën e rregjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra*
- ☐ *datën e caktimit të masës së sigurimit*
- ☐ *datën e marrjes së kallëzimit*
- ☐ *datën kur personi merret si i pandehur.*

**2. Në lidhje me mbrojtësin e të pandehurit, cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë:**

- ☐ *mbrojtësi i zgjedhur nga i pandehuri është i detyruar ta pranojë emërimin*
- ☐ *mospranimi i emërimit nga mbrojtësi i zgjedhur i fillon efektet 30 ditë pasi i komunikohet organit që procedon*
- ☐ *mbrojtësi i të pandehurit konsiderohet nëpunës publik*
- [+] *i pandehuri ka të drejtë të zgjedhë një ose e shumta dy mbrojtës*
- ☐ *kur i pandehuri është nën 18 vjeç, të drejtat e mbrojtësit munt t'i ushtrojë prindi ose kujdestari i tij.*

**3. personi i pezulluar, qoftë edhe përkohësisht, nga detyrat publike apo nga ushtrimi i një profesioni, nuk mund të ushtrojë detyrën e ekspertit:**

- ☐ *varet nga lloji i ekspertimit;*
- [+] *asnjëhere, sepse pengohet nga ligji*
- ☐ *papajtueshmëria me detyrën e kespertit ka vetëm i mituri*
- ☐ *ligji nuk vendos kufizime të tilla;*
- ☐ *po, por vetëm në rastin kur ka kufizime të tjera.*

**4. Lidhur me temën e provave është i vërtetë pohimi:**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SHKOLLA E MAGJISTRATURËS TIRANË

- [ ] *Provat që nuk rregullohen me ligj përjashtohen nga shqyrtimi gjyqësor*
- [x] *Deklarimet e bashkëtëpandehurit duhet të mbështeten nga prova të tjera* ✓
- [ ] *Papërdorshmëria mund të ngrihet vetëm gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe në apel*
- [ ] *Bindja e brendshme e gjykatës bazohet kryesisht në provat e marra gjatë hetimeve paraprake*
- [ ] *Provat merren me kërkesën e palëve, gjykata nuk ka të drejtë të ndërhyjë.*

**5. seksionet e policisë gjyqësore krijohen:**

- [ ] *Pranë çdo prokurorie dhe kryejnë vetëm funkione të policisë gjyqësore*
- [x] *Pranë çdo prokurorie dhe kryejnë funskione ndihmëse në shërbim të prokurorit* ✗
- [ ] *Pranë prokurorisë së shjkallës ësë parë dhe kryejnë funskione administrative*
- [ ] *Pranë çdo prokurorie apeli dhe mund të kryejnë funskione të polisicë gjyqësore, por vetëm kur kjo u kërkohet nga prokurori*
- [ ] *Pranë Prokurorisë kundër Korrupsionit dhe krimit të organiziuar, por vetëm me kompetencë të kufizuar lidhur me veprat penale të korrupsionit.*

**III.Pyetje Konceptuale (2 pyetje, 10 pikë)**

1. **Cila është pasoja që shkakton mbarimi i afatit të hetimeve paraprake? Ilustroni konceptin me anën e një shembulli. (5 pikë)** 4 Pikë

- Mbarimi i afatit të hetimeve paraprake, sjell si pasojë papërdorshmërinë e çdo prove apo të dhëne të grumbulluar pas përfundimit të afatit të hetimeve paraprake. ✓

- Kur gjykata cakton një afat brenda të cilit prokurori duhet të përfundojë hetimet, atëherë ato (hetimet) duhet të mbyllen brenda këtij afati. Për sa i përket nëse hetimet nuk mbyllen në afatin e caktuar nga gjykata, çdo provë apo veprim i marrë apo rezultuar pas mbarimit të afatit, nuk është i vlefshëm e nuk mund të përdoret.

- Shembull: Kur pala nën hetim ka kërkuar vendimin e zgjatjes së afateve të marrë nga prokurori, gjykata e mund t'i lërë një afat prokurorit p.sh. 15-ditë për përfundimin e hetimit. Nëse nuk përfundojnë brenda 15-ditëve prokurori, nuk mund të vazhdojë hetimet. Neni sipas nenit 324 të K. Pr. Penale. Shembulli nuk e sqaron konceptin plotë!

2. Gjykata jep vendim dënimi kur fajësia e të pandehurit provohet «përtej çdo dyshimi të arsyeshëm». **Si e kuptoni këtë normë të ligjit procedural? (5 pikë)** 5 Pikë

- Ky parim Kushtetues parashikohet edhe në K. Pr. Penale. Ai nënkupton që, vendimi i dënimit të personit mund të jepet

vetëm kur që provohet në mënyrë të plotë dhe bindëse nga provat e shqyrtuara dhe administruara në gjykim. Fajësia duhet të provohet nga gjykata, nga vlerësimi i provave dhe bindjes së brendshme kur provat janë në unitet me njëra-tjetrën, dhe dënimi nuk mund të jepet vetëm mbi bazën e një prove që nuk paraqet lidhshmëri apo unitet me provat e tjera sipas nenit 152, 384 të K.Pr.Penale
- Çdo dyshim që lind në lidhje me akuzën e pandehur apo të ngritur në gjykim, duhet të zgjidhet në favor të të pandehurit.

IV. Pyetje krahasuese (15 pikë)

11 Pikë

1. Tregoni dallimet midis pavlefshmërisë absolute me pavlefshmërinë relative të akteve.

- Pavlefshmëria Absolute, ju referohet vetëm rasteve specifike që parashikohen në nenin 128/a të K.Pr.Penale. Pavlefshmëria absolute, nuk mund të rregullohet me një akt tjetër dhe ju referohet rasteve: Kur nuk konsiderohen
1) Që lidhen me ushtrimin e funksionit të gjyqtarit
2) Ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori.
3) Aktet e prodhuara kur nuk është njoftuar viktima, i pandehuri, mbrojtësi, kur këta të fundit parashikohen të detyrueshëm në fazën apo veprimin e dhënë.

- Pavlefshmëria Relative, ju referohet çdo pretendimi që mund të ngrihet mbi aktet, i ndryshëm nga ai i parashikuar në nenin 128/a të K.Pr.Penale. Pavlefshmëria relative zgjidhet nga organi procedues! Po pavlefshmëria absolute?
Pavlefshmëria relative, duhet të ngrihet sa më shpejt të jetë e mundur dhe menjëherë sapo palët njihen me të (aktin)
Kur s-akt vlerësohet i pavlefshëm, atëherë parashikohen (kur është e mundur) edhe mënyrat e ripërtëritjes së aktit => konsiderohet.
Pavlefshmëria relative ngrihet vetëm me kërkesë të palës, ajo absolute edhe kryesisht!

## V. Pyetje zhvilluese (10 pikë):

1. Cili është kuptimi dhe çfarë synon të realizojë urdhri penal i dënimit? 10 pikë

- Urdhri Penal i Dënimit, u parashikua si një risi e sjellë me ndryshimet ligjore të vitit 2017 (ligji nr. 35/2017)

- Prokurori, kur procedon për një kundërvajtje penale, brenda 3-muajve nga regjistrimi i procedimit penal, dhe kur çmon se nuk janë kushtet për t'u kërkuar / caktuar një dënim me burgim, mund të disponojë me urdhër penal.

- Urdhri penal përcakton një dënim me gjobë, i cili nuk mund të jetë më shumë se gjysma e masës së gjobës së parashikuar nga Kodi Penal për kundërvajtjen penale.

- Urdhri penal krahas dënimit me gjobë, mund të parashikojë edhe një ose më shumë dënime plotësuese sipas Kodit Penal, apo e përgjithshme.

- Urdhri Penal, mund të disponohet, pasi prokurori të ketë hetuar / verifikuar më gjendjen ekonomike të të pandehurit.

- Synimi i urdhrit penal është pasi ka ekonomizuar kohën e hetimit dhe gjykimit, kur disponohet brenda 3-muajve nga regjistrimi i procedimit penal dhe nga ana tjetër, ai verifikon paraprakisht nëse janë respektuar kushtet e urdhrit penal.

- Është synuar dhe arritur ekonomia gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore

- Ka edhe parim human, sepse me pagimin e gjobës, i pandehuri quhet i padënuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË SHKOLLA E MAGJISTRATURËS TIRANË

**Kazus 9** **(50 pikë)**

**Prokuroria vs L.L.**

E pandehura L.L. me detyrë përgjegjëse e zyrës së financës në Komunën e Luzit të Vogël, gjatë ushtrimit të detyrës, ka kryer shkelje të disiplinës financiare duke i shkaktuar shtetit dëm në vlerën 7.249.394 lekë. Më konkretisht, shkeljet e kryera nga e pandehura listohen në vijim:

1. E pandehura L.L. është një nga dy subjektet, që ka përpiluar dhe firmosur mandat arkëtimet nr. 1447 datë 11.12.2007, nr. 1253 datë 12.12.2005 dhe nr. 1215 datë 29.12.2006. Këto mandate kanë të bëjnë me pagesën e bërë nga shoqëria "H..." për qira trualli, për llogari të Komunës Luz i Vogël. Të tre këto mandate rezultojnë të papasqyruara dhe të paregjistruara në librin e arkës së komunës.

2. Me urdhër pagesën me nr. 17 datë 25.02.2008, rezulton se nuk është likuiduar shtetasi H.A, por kjo pagesë është bërë/ka kaluar për llogari të shoqërisë "E..." shpk, veprim financiar i pajustifikuar me dokumentacionin e administruar në praktikë.

3. E pandehura ka kryer likuidimin e urdhër pagesës me nr. 86 datë 27.07.2007, për llogari të shtetasit D.L., si dhe urdhër pagesës nr. 73 datë 02.06.2008, bërë në emër dhe për llogari të shtetasit V.G., pa dokumentacion justifikues.

4. Me urdhër pagesën nr. 141 datë 19.12.2007, shoqëria "R..." shpk., ka përfituar shumën 398.000 lekë për projektimin e rrugës "Vorozen-fshat Luz i Vogël". Ky projekt ndodhet në dosje, por nuk është bërë hyrje në magazinë. Ky tender nuk është zhvilluar fare, ai është anuluar dhe nuk ka kontratë të lidhur midis dy palëve.

5. Në lidhje me pagesat e përfituara nga shtetasja M.D.me urdhër pagesën nr. 13. datë 05.02.2008, në shumën prej 388.000 lekë dhe urdhër pagesën nr. 05, datë 12.12.2008 për shumën 207.700 lekë, si dhe pagesat në favor të shtetasit V.D. me urdhër pagesë nr. 56, datë 12.12.2008 për shumën 133.000 lekë, e pandehura ka iniciuar, nënshkruar dhe kaluar për likuidim shuma të hollash, duke u bazuar në dokumentacion justifikues të pasaktë dhe jo të plotë.

6. Në lidhje me pagesat e kryera në favor të shtetasit I.X., me urdhër pagesën nr. 20 datë 03.12.2007, në shumën prej 193.140 lekë, si dhe me urdhër pagesën nr. 63, datë 14.05.2008 në shumën prej 230.000 lekë, e pandehura ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 8460, datë 28.12.1998 "Për procedurat tatimore" (i ndryshuar), si dhe është konstatuar se dokumentacioni i përzgjedhjes së ofertave është plotësuar në shkelje të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik".

7. E pandehura L.L. ka tërhequr dhe ka bërë hyrje të disa materialeve që nuk janë likuiduar. Dokumentacioni që shoqëron këto blerje paraqet të meta, megjithatë rezulton e firmosur nga e

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
TIRANË

pandehura në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore, që normojnë detyrën e saj si kryetare e degës së buxhetit.

8. Komuna ka zhvilluar tenderi me objekt 'pastrimi i mbeturinave të fshatrave të komunës Luz i vogël'. Procedura e tenderimit rezulton të jetë kryer e plotë dhe të jetë shpallur fitues shoqëria "En..." shpk. Dokumentacioni i tij nuk është ruajtur në kundërshtim me ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984 "Për ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare", si dhe me ligjin nr. 7661, datë 19.01.1993, "Për Kontabilitetin".

9. Nga kontrolli i librit të arkës dhe mandat arkëtimeve për muaji prill dhe maj 2007, është konstatuar se mandat arkëtimet e 9 subjekteve të biznesit të vogël nuk figurojnë të regjistruar në librin e arkës dhe në ditarin e arkës së komunës, edhe pse këto subjekte e kanë paguar taksën dhe janë të pajisur me mandate arkëtimet për shumat përkatëse.

**Pyetje për zgjidhje:**

**1.** Fakti që e pandehura L.L ka kryer disa herë një vepër penale të njëjtë, nëpërmjet të njëjtit mekanizëm veprimesh, a çon kjo në kualifikimin e tyre si krim vazhdues apo ajo duhet dënuar për sa veprime penale ka kryer? **(15 pikë)**

**2.** Si qëndron dhe ndikon falsifikimi i dokumenteve zyrtare në raport me përvetësimin e shumave monetare? A kemi konkurrim veprash apo përthithen nga njëra-tjetra? **(15 pikë)**

**3.** Çfarë përgjegjësie kanë përfituesit e tjerë, si M.D, I.X, shoqëria "R..." shpk lidhur me veprat penale të kryera nga e pandehura L.L? **(10 pikë)**

**4.** A kemi bazë të mjaftueshme për përgjegjësinë penale të shoqërisë "R..." shpk? **(10 pikë)**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
TIRANË

## KAZUS 9[12]

***Rrethanat e faktit***

Paditës Q.D ka kërkuar e padi kundër F.M dhe P.D dhe person i tretë Shoqëria "AL&GI" TIRANE:

a) Dorezimin e pasurisë qe rrjedh nga trashegimia dhe
b) Pavlefshmerinë e kontrates se dhurimit date 13.11.1997.

Paditesja Q. D dhe i padituri F.M jane moter e vella dhe trashegimtare ligjore te trashegimlenesit M. M.
Paditesja, per te realizuar te drejten e saj qe rrjedh nga e drejta e trashegimise, ka thirrur ne cilesine e te paditurit pervec bashketrashegimtarit F.M dhe kunatin e tij P.D. dhe ne cilesine e personit te trete shoqerine tregtare "AL&GI".

Komisioni i Kthimit e Kompensimit te Pronave te Rajonit nr.1 te Bashkise Tirane me vendimin nr.1345, date 30.11.1996 ka njohur pronar babain e tyre M. M. nder te tjera, edhe per nje truall te zene me siperfaqe 17.980 m2 se bashku me vellezerit e tij, e cila do t'i kompensohej me nje nga menyrat e parashikuara nga neni 16 i ligjit nr.7698, date 15.04.1993 "Per kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronareve".
Ne zbatim te se drejtes se kompensimit qe kishte fituar babai i tij, trashegimlenesi M.M, i padituri F.M. i eshte ridrejtuar K.K.K.Pronave per kompensimin e siperfaqes se tij **te pandare** dhe me vendimin nr.114, date 28.08.1997 i eshte kompensuar ne natyre nje siperfaqe prej 1200 m2. Ne piken nr.2 te vendimit te K.K.K.Pronave thuhet ne menyre te shprehur: "Ish pronari F.M, mbas kompensimit sipas pikes 1 te ketij vendimi, humbet te drejten e kompensimit te fituar ne baze te vendimit nr.1345, date 30.11.1996 te atij komisioni per siperfaqen 1200 m2. Nga siperfaqja 4495 m2 (1/4 pjese e sip. 17.890 m2 pershkruar me lart), mbeten 3295 m2 (4495-1200=3295), per kompensim te pritshem trashegimtareve te M.M. Ndersa, nga e gjithe prona e percaktuar per kompensim (vendimi 1345), mbeten 16.890 m2, per te gjithe bashkepronaret (17.890-1200=16.890)". Sipas vendimit te mesiperm te K.K.K.Pronave mbetej per kompensim te pritshem per trashegimtaret e M.M. 3295 m2 dhe per te gjithe bashkepronaret (trashegimtaret), etj., 16.890 m2.

Me daten 13.11.1997 i padituri F.M., truallin me sip. 1200 m2 te marre me vendimin e mesiperm te K.K.K.Pronave me nr.114, date 28.08.1997 ja ka dhuruar te paditurit tjeter P. D. Ky i fundit me kontrate sipermarrje me shoqerine "AL&GI" ka perfunduar ndertimin e dy pallateve mbi kete truall.

[12] Vendimi Unifikues i GJL Nr. 6, datë 24.01.2007.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
TIRANË

Me padine objekt gjykimi, paditesja Q. D ka kerkuar dorezimin e pasurise trashegimore, qe mbahet prej te padituve ne menyre te paligjshme dhe pavlefshmerine e kontrates se dhurimit. Kerkimet paditesja i ka mbeshtetur ne nenet 92 dhe 349 te Kodit Civil.

**Gjykata e shkalles se pare Tirane** me vendimin nr.2756, date 17.06.2003 ka vendosur pranimin e kerkese padise se ngritur nga paditesja, detyrimin e te paditurit t'i dorezoje pasurine trashegimore ne 1/8 pjese dhe konstatimin absolutisht te pavlefshem te veprimit juridik te dhurimit te kryer midis te padituve me arsyetimin se: *"Ky veprim juridik eshte absolutisht i pavlefshem, pasi pasuria truall prej 1200 m2 qe eshte dhuruar nga F.M nuk eshte e F.M, por e te gjithe trashegimtareve ligjore te M.M, pasi F.M nuk ka qene pronar i vetem i kesaj pasurie dhe e ka dhuruar kete pasuri pa pelqimin e trashegimtareve ligjore".*

**Gjykata e Apelit Tirane** me vendimin nr.1259, date 11.12.2003 ka vendosur prishjen e vendimit nr.2756, date 17.06.2003 te Gjykates se shkalles se pare Tirane dhe dergimin e çeshtjes per rigjykim per shkelje te renda te normave procedurale ne lidhje me perberjen e trupit gjykues te parashikuara nga nenet 181/3, 467/b dhe 472/b te Kodit te Procedures Civile.

Pas rigjykimit, **Gjykata e shkalles se pare Tirane** me vendimin nr.2843, date 04.06.2004 ka vendosur rrezimin e padise te ngritur nga paditesja si te pambeshtetur ne ligj, me arsyetimin se: Trualli objekt konflikti i eshte dhene ne pronesi te paditurit ne baze te se drejtes se kompensimit qe ai ka pasur. I padituri kete truall e ka fituar jo sepse ky ka qene dikur i trashegimlenesit te tij. I padituri eshte bere per here te pare pronar mbi kete truall, sepse deri atehere ka qene ne pronesi te shtetit; Ne baze te vendimit nr.114, date 28.08.1997 te K.K.K.Pronave, kompensimi eshte bere per llogari te F.M dhe jo te trashegimlenesit te tij M.M. Mbi truallin e kthyer per efekt te kompensimit, ish-pronari M.M nuk ka pasur ndonjehere ndonje te drejte pronesie; Ish-pronari M.M nuk kishte si te linte me trashegim nje te drejte qe nuk e kishte pasur ndonjehere; Trualli prej 1200 m2 objekt konflikti asnjehere nuk ka qene ne pronesi te M. M dhe as i eshte njohur atij me vone ne emrin e tij; Paditesja nuk heq nga trashegimlenesi i saj asnje te drejte mbi sendin konkret objekt konflikti; Duke qene se nuk gjendet i bazuar kerkimi i pare i padise, automatikisht rrezohet edhe kerkimi i dyte, pavlefshmeria absolute e kontrates se dhurimit, pasi eshte kerkim i ndervarur nga kerkimi i pare.

**Gjykata e Apeljt Tirane** me vendimin nr.514, date14.04.2005 ka vendosur lenien ne fuqi te vendimit nr.2843, date 04.06.2004 te Gjykates se shkalles se pare Tirane me rasyetimin se Perderisa origjina e prones e te paditurit Fatmir Maçi nuk rrjedh nga trashegimia, por e perfituar si kompensim ne njeren nga menyrat qe parashikon neni 16 i ligjit nr.7698, date 15.04.1993, paditesja nuk gezon te drejten ne kerkimet e saj sipas objektit te padise.

**Kunder vendimit te Gjykates se shkalles se pare Tirane dhe Gjykates se Apelit Tirane ka ushtruar rekurs paditesja,** e cila ka kerkuar prishjen e te dy vendimeve dhe kthimin e çeshtjes per rigjykim ne shkalle te pare, duke parashtruar se gjykatat kane gabuar ne zbatimin e ligjit. Kolegji Civil i Gjykates se Larte me vendimin dates 13.06.2006 ka vendosur kalimin e çeshtjes per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte per efekt te njehsimit te praktikes gjyqesore.

**Jepni përgjigjen e pyetjeve të shtruara për diskutim:**

1) *Nese ne rastin e kompensimit qe i behet prones se zene te njerit prej bashkepronareve do te ndodhemi para pasurise trashegimore, d.m.th. trualli qe jep shteti [illegible] e tij*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SHKOLLA E MAGJISTRATURËS - TIRANË

*do te quhet se eshte pasuri trashegimore, apo do te trajtohet si kompensim (marredhenie detyrimi)?* ***(10 pikë)***

2) *A është (ka qenë) detyrë e Komisionit të Kthimit të Pronave pjesëtimi I pasurisë së ish-pronareve dhe t'ua ktheje ate te gjithe trashegimtareve veç e veç?* ***(5 pikë)***
3) *Kur shteti, me vendim te K.K.K.Pronave, i ka kaluar te drejten e pronesise per efekt te kompensimit (per truallin e zene) njerit prej trashegimtareve a e ka permbushur detyrimin e tij per te gjithe trashegimtaret ligjore qe fitojnë apo heqin te drejta nga trashegimlenesi I tyre?* ***(5 pikë)***
4) *A është padia e kerkimit te trashegimise nje padi per njohjen bashkepronare?* ***(5 pikë)***
5) *A është ndërtuar drejtë ndërgjyqësia në këtë padi? A ka vepruar drejtë paditësja që padinë per kerkimin e trashegimit e ka ngritur kunder te padituurve dhe kunder personit te trete qe ka perfituar pasurine trashegimore me kontraten e sipermarrjes?* ***(10 pikë)***
6) *Si ka vendosur Gjykata e Larte ne kete rast lidhur me fatin e gjykimit dhe vendimmarjen e gjykates se shkalles se pare dhe te apelit dhe çfare ka unifikuar ajo?* ***(15 pikë)***

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SHKOLLA E MAGJISTRATURËS - TIRANË

38

# KASUS PENAL

15

Përgjigje 1:

E pandehura, në rastet e konstatuar, përmes veprimeve të saj të kundërligjshme: ka kryer veprime të cilat kanë konsistuar në:

- mos mbajtje e rregullt e librit të arkës
- pagesë pa justifikimin e duhur dokumentar
- pagesë për tender të pa kryer (fiktiv)

-> Të gjitha faktet penale të mësipërme ju referohen situatave që kanë të bëjnë me mos paraqitje të rregullt të detyrës e me pagesë të tenderit për interesat e ligjshme të shtetit.

-> Faktet penale të pagesave me dokumentacion jo të plotë, mos mbajtje e rregullt e librave të arkës dhe humbje e mandatave për disa subjekte, përbëjnë elemente të cilat lidhen me të njëjtën dimension të paligjshme sjelljeje dhe të të pandehurës. Kjo lloj sjelljeje e bën krimin vazhdues.

-> Fakti që lidhet me fiktivitetin e tenderit përbën elementët e veprës "Shkelja në barazinë në tendera", pasi lidhen jo vetëm me parimin e detyrës, por edhe me cenimin e mos të drejtave të subjekteve të tjerë pjesëmarrës në tendera

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SHKOLLA E MAGJISTRATURËS TIRANË

Përgjigje 2:

3

Falsifikimi i dokumentave në kuadër të përvetësimit të shumave monetare, në rastin konkret përbën një nga elementet e domosdoshëm (të paligjshëm) për të sjellë veprën penale të përvetësimit të shumave.

Duke u përdorur si element, në këtë rast falsifikimi, nuk mund të gënohojë si figurë më vete e veprës penale të "Falsifikimi i dokumentit" por përthithet nga vepra e përvetësimit të shumave.

Mendoj që nuk kemi konkurrim veprash përsa i përket falsifikimit, pasi ky i fundit do të përthithej nga përvetësimi i shumave.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
TIRANË

Pyetja 3:

(10)

M.D -> dokument i pasaktë dhe jo i plotë (gjatë hetimit)
1.X -> dokument në shkelje të Procedurave tatimore dhe ligjit për prokurimin publik.
2. shpk -> nuk është kryer procedura prokuruese e mjedhimshte, nuk është dhënë shërbimi.

Për subjektet M.D dhe I.X mendoj se nuk kemi bazë të mjaftueshme për sa i përket konsumimit të ndonjë vepre penale.

Nëse "pasaktësia" i referohet (elementit të dokumentit, atëherë do të përgjigjeni për këtë vepër penale

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
TIRANË

10

Përgjigje 4:-

Subjekti "R" Shpk → ka përfituar një shumë, duke qënë në dijeni se, nuk ka kryer asnjë punë apo shërbim për të cilin madje edhe kontraktimi është anulluar. Në këtë rast, rezulton të jetë falsifikuar një praktikë e plotë, mbi një procedurë që nuk është kryer. Këto veprime aktet të subjektit R Shp, e kanë të provuar kundërligjshmërinë e tyre dhe qëllim subjektive të tij, për të përfituar dokumentacion të falsifikuar, duke e ditur që këto akte janë fiktive. Fakti është i provuar gjithë edhe duke kqyrur vendin apo shërbimin që nuk është dhënë kurrë nga Subjekti R, SHPK

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHKOLLA E MAGJISTRATURES
TIRANE

# KASUS CIVIL

Përgjigje Kazusit Civil:

Pika 1: Në rastin e kompensimit që i bëhet pronësisë të ardhur prej bashkëpronarëve do të ndodhemi para pasurisë (trashëgimore dmth. trualli që jep shteti nga prona e tij do të quhet pasuri trashëgimore, apo kompensim (mangësi detyrimi)?

Përgjigje Pika 1: Në rastin konkret në përputhje me ligjin "Për kthimin e kompensimit të pronave..." Komisioni ka ndërmarrë një vendim, për t'i njohur (dhe kthyer kur është rasti) pronat ish-pronarëve, nisur nga fakti se këto prona në kohën e sistemit monist, sipas ligjeve të këtij sistemi, iu ka hequr dhe mohuar të drejtën e pronësisë së tyre.

- Me ligjin "Për kthimin..." shteti përcaktoi dhe mori përsipër detyrimin që për këto padrejtësi të sistemit që shteti, t'i rregullonte pasojat duke iu njohur e kthyer (apo kompensuar) pronat ish-pronarëve.

- Në rastin konkret, kemi para një marrëdhënie detyrimi, që shteti ka ndaj ish-pronarëve. Në këtë rast, ky detyrim ka lindur nga ligji. Ligjërisht që detyrimet "lindin nga ligji" dhe kontrata.

- Pasuria prej 1.200 m truall në rastin konkret ka qenë në zbatim apo përmbushje

e një detyrimi të lindur me ligj, si e tillë do të trajtohet si kompensim pra marrëdhënie detyrimi dhe jo trashëgimie.

Në rastin e kompensimit të truallit 1200 m, jemi para një marrëdhënie detyrimi ndërmjet Shtetit dhe ish-pronarit.

- Pika 2: A është (ka qenë) detyrë e K.K.P, përcaktimi i pasurisë së ish-pronarëve dhe t'ju a kthejë atë të gjithëve veç e veç?

Përgjigje 2: K.K.P. ka patur detyrim që pasurinë t'ja kompensojë ish-pronarit. Përcaktimi i pasurisë të trashëgimtarëve (si ish-pronar) përbën një proces që ju përket trashëgimtarëve dhe K.K.P, nuk ka patur asnjë detyrim për t'ia përcaktuar pasurinë për çdo trashëgimtar veç e veç.

Pika 3; përgjigje: Në rastin konkret

K.K.P, është në pozitën e Debitorit, karshi disa trashëgimtarëve (të ish-pronarit) që janë në pozitën e Kreditorëve. (Solidaritet)

Ndodhemi para një marrëdhënie solidare, ku të cilën Debitori çlirohet nga detyrimi duke e përmbushur atë, qoftë edhe ndaj njërit prej kreditorëve.

Duke ja kthyer pronën F.M, K.K.P, ka përmbushur detyrimin e tij, karshi të gjithë trashëgimtarëve ligjorë që kanë (kishin) të drejta nga trashëgimlënësi (ish-pronar)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
TIRANË

Pika 4; Përgjigje:

Padia për njohje trashëgimtare, është një padi përmes së cilës trashëgimtari kërkon nga çdo person (qoftë edhe trashëgimtari me 1-titull), njohjen trashëgimtar dhe dorëzimin e pasurisë.
Në rastin konkret, kur trashëgimi bëhet ndaj personit që është trashëgimlënës, sikurse paditësja, padia e kërkimit të trashëgimit, përbën një padi për njohjen bashkëpronare.

Pika 5, Përgjigje:

Mendoj se paditësja ka vepruar drejt kur ka kërkuar njohjen pronar dhe dorëzimin e pasurisë trashëgimore nga personat që e mbajnë pasurinë e saj.
Por, mendoj gjithashtu se Paditësja personin apo Subjektin ndërtues "AL&GI", i cili ka marrë me sipërmarrje dhe ka zhvilluar mbi pjesën e saj të pasurisë trashëgimore, mund ta thërresë në pozitën procedurale të të Paditurit (jo person i tretë).
Kujtojmë që sipas nenit 349, 350 të K. Civil, padia për kërkimin e trashëgimit (pjesës së saj) mund të ngrihet kundrejt cilitdo që e mban apo posedon pjesën e saj të pasurisë trashëgimore. Se kohë provohet që pasuria e posedohet edhe nga "AL&GI", kërkimi i saj mund të kundrejtohet dhe të thërrasë të

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
TIRANË

paditur edhe këtë subjekt, krahas sikurse me të drejtë ka thirrur të paditur, vëllain e saj (ish-trashëgimtar) dhe personin që e ka marrë me dhurim.

Pika 6, përgjigje: Megjithëse, nuk e kujtoj dispozitivin e gjykatës së lartë për rastin, shprehem se:

* duhet të kete disponuar me prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të shkallës së parë dhe kthimin për rigjykim në këtë të fundit (kjo edhe për shkak të vlerësimit me interpretim dhe kërkimi që mund të ngrihen dhe gjykohen vetëm në këtë shkallë gjykimi)

* Janë konfirmuar:

- Në rastin e kthimit/kompensimit të pronave K.K.P. ka përmbushur një detyrim ligjor ndaj ish-pronarëve dhe tij trashëgimtarit.

- Me kthimin e pasurisë tek një ish-pronar K.K.P, ka përmbushur finalisht dhe në mënyrë përfundimtare detyrimin e saj, pa patur nevojën e ndarjes në pjesë për secilin trashëgimtar të ish-pronarit.

- Padia për njohje dhe kthim pasurie trash. është e bazuar dhe e mbështetur plotësisht në nenet 349 dhe 350 të K. Civil por duhet të mbahet në konsideratë mirëbesimi dhe keqbesimi i poseduesit që e mban këtë pasuri.

Si moment i fondit, mendoj se, gjykata e faktit, duhet të shtrijë hetimin e saj, në drejtim të verifikimit të kushteve të mirëbesimit / keqbesimit të personit që e mbou pasurinë.

Në varësi të kësaj të fondit, merret vendim për kthimin e pasurisë trashëgimore, apo kthimin vetëm të kundërvlerës së saj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
TIRANË